



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

Raporti i rregullt i punës
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Janar – Dhjetor 2023

RAPORTI I RREGULLT I PUNËS SË GJYKATËS THEMELORE NË FERIZAJ
(Periudha 1 janar deri me 31 dhjetor 2023)

Bazuar në nenin 14 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit për Gjykatat, Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, paraqet raportin e rregullt të punës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2023.

Gjykata Themelore në Ferizaj dhjetor të vitit 2023 ka hartuar planin e punës së gjykatës për vitin 2024, i cili plan vjetor i punës është aprovuar në kolegjiunin e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore dhe degëve të saj të mbajtur me datë 12 janar 2024 dhe i njëjti i dërgohet KGJK-së për aprovim, në kuadër të cilit planit të punës për vitin 2024, është avancimi dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të gjykatës në drejtim të përvojave funksionale, zbatimi dhe respektimi i ligjeve për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë zbatimi dhe respektimi i planeve strategjike të nxjerra nga Këshilli Gjyqësorë i Kosovës për zgjedhjen sa më efikase të lëndëve, komunikimi me media si dhe me akterët e tjerë, organizimi i punës së gjykatës dhe administratës gjyqësore, si dhe zbatimi në tersi i projektit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve SMIL.

Gjykata Themelore në Ferizaj me degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpçë, përmes këtij raporti prezanton në mënyrë përmbledhëse punën e gjykatës për vitin 2023 (janar – dhjetor), duke prezantuar njëkohësisht të arriturat, sfidat gjatë kësaj periudhe raportuese, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë administrativ, me qëllim të paraqitjes së volumit të punës së kryer në formë statistikore, tabelore dhe diagrameve në vazhdim.

Aktualisht Gjykata Themelore në Ferizaj me Degët Kaçanik dhe Shtërpçë ka të angazhuar gjithsejtë njëzet e shtatë (27) gjyqtarë duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës. Ndërsa numri total i të punësuarve në Administratën e Gjykatës Themelore në Ferizaj së bashku me degë është 130 persona përfshirë Administratorin e Gjykatës dhe dy ndihmës administratorë (85 të punësuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, 22 ne degën e gjykatës Kaçanik dhe 23 në degën e gjykatës Shtërpçë).

Gjatë vitit 2023, një gjyqtare nga Departamenti i Përgjithshëm Penal nga muaji qershor gjendet në pushime të lehonisë, ndërsa në fillim të këtij me dt.5 janar 2024 një gjyqtarë i Departamentit civil ka arritur moshën e pensionimit. Ndërsa gjyqtari Bersim Shaipi është pensionuar me datë 07.08.2023.

Në aspektin financiar, gjatë periudhës raportuese ekipi financiar ka qenë i konsoliduar dhe ka arritur të përfundoj me sukses detyrat që kanë të bëjnë me çështje financiare. Në këtë periudhë raportuese janar-dhjetor 2023 zyra e financave ka realizuar të hyra gjyqësore të cilat janë derdhur në Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës e që kanë qenë 1,090, 589.80 €, prej tyre 742,387.00 € janë të hyra nga gjrobat dhe 348,202.80 € pagesa nga taksat dhe paushallët gjyqësore, ndërsa shpenzime buxhetore për nevojat e gjykatës gjatë këtij viti kanë qenë 223,700.00 €, prej tyre 93,710.09 € janë shpenzuar për mallra dhe shërbime si dhe shpenzime komunale, ndërsa kanë mbetur të pa shpenzuara 129,989.91 €.

Web portali i gjyqësorit edhe për këtë periudhë ka shërbyer si urë lidhëse ndërmjet publikut dhe gjykatës kjo me qëllim të informimit të publikut rreth aktiviteteve, orarit të seancave gjyqësore, vendimeve dhe të tjera, ndërsa përmes rrjetit social facebook publikut i është mundësuar qasje e lehtë në punën e gjykatës. Përveç këtyre shërbimeve të cilat ofrohen në portalin gjyqësorë dhe rrjetet sociale, si shërbime shtesë të cilat dëshmojnë transparencën e gjyqësorit karshi publikut, në hyrje të gjykatës janë të vendosur monitor të cilët pasqyrojnë kalendarin me orarin e seancave gjyqësore si dhe tabela orientuese, këto si në gjykatën Themelore në Ferizaj ashtu edhe në degët Kaçanik dhe Shtërpçë.

Në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Projekti i filluar për regjistrimin e lëndëve kundërvajtëse të cilat kanë plotësuar kushtet ligjore për asgjësim për periudhën janar-dhjetor 2023 kanë arritur të regjistrohen gjithsejtë 107.215 lëndë.

Gjykata Themelore në Ferizaj së bashku me degët gjatë viti 2023, ka angazhuar të gjithë zyrtarët e IT-së si dhe zyrtarët e sistemit Smil, nga të cilët është kërkuar barazimi i lëndëve me lëndët që janë fizikisht në zyre të gjyqtarëve me lëndët e regjistruara në Smil, proces ky i cili ka përfunduar dhe se tani kemi evidenca të sakta sa i përket numrit të lëndëve të cilat janë në procedurë në gjykatën tonë.

Statistikat

Gjykata (së bashku me degë) gjatë vitit 2023, ka të evidentuara në punë 38.314 lëndë, prej tyre janë përfunduar 12920, ndërsa trashëgohen në vitin 2024 si të pa përfunduara 25.394 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit është afër 92.11 % . Divizioni për Kundërvajtje ka pas të evidentuara në punë 7972, prej tyre janë përfunduar 3907 ndërsa barten në vitin 2024, 4065 lëndë.

Departamenti për Krime të Rënda, gjatë vitit 2023 ka pranuar 84 lëndë, ka përfunduar 173, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 139 lëndë (në këtë departament janë mbi 50 lëndë pasive). Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në DKR është 205.95 % .

Departamenti për të Mitur, ka pranuar 97 lëndë, ka zgjidhur 142 lëndë, ndërsa kanë mbetur në punë 51 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në këtë Departament është 146.93%.


Departamenti i Përgjithshëm përkatësisht Divizioni Penal (së bashku me degë) nga gjithsej 4394 lëndë sa ka pasur në punë, prej tyre të pranuar gjatë vitit 2023 janë 1502 lëndë, ka zgjidhur 1793, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 2601. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në DP është 119.37 %.

Divizioni Civil, (së bashku me degë) nga gjithsej 13509 lëndë sa ka pasur në punë, prej tyre gjatë vitit 2023 janë pranuar 5849 lëndë të reja, ka zgjidhur 3942, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 9567 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në DC është 67.40%.

Raportet statistikore sipas viteve pasqyrojnë, efikasitetin në kryerjen e lëndëve në Gjykatën Themelore në Ferizaj, pas reformave në gjyqësor të vitit 2013 deri më 2023, përkatësisht krahasimet e viteve paraprake për lëndët e pranuar dhe lëndët e zgjidhura, përveç raporteve të paraqitura si më lartë në lëmin civile, ku në vitin 2023 ka vazhduar trendi i ardhjes numrit të lartë të kërkesave dhe padive kryesisht që kanë të bëjnë me kontratat kolektive nga mësimdhënësit, shëndetësia, Policia e Kosovës etj (paga jubilarë, shujtat, licencimet), të cilat lëndë të kësaj natyre


kanë ndikuar shumë në ngritjen e përqindjes së lëndëve në Gjykatë, e po ashtu kanë ndikuar në uljen e përqindjes së shkallës së spastrimit të lëndëve në përgjithësi.

Diagrami pasues pasqyron se: Gjykata Themelore në Ferizaj gjatë vitit 2013 ka pranuar 16.397 lëndë, gjatë vitit 2014 ka pranuar 36.398 lëndë, në vitin 2015 ka pranua 35.646 lëndë, në vitin 2016 ka pranuar 38.739 lëndë. Për periudhën e vitit 2017 gjykata ka pranuar 17.677 lëndë, gjatë vitit 2018 15.687, gjatë vitit 2019 janë pranuar 17.400 lëndë, gjatë vitit 2020 janë pranuar 12.306 lëndë, gjatë vitit 2021 janë pranuar 14841 lëndë, gjatë vitit 2022 janë pranuar 16719 lëndë , ndërsa në periudhën e vitit 2023 janë pranuar 13535 lëndë. Kjo rënie e numrit të lëndëve të pranuar nga vitet paraprake është shënuar kryesisht në Divizionin për Kundërvajtje. Por siç u theksua edhe më lartë përveç lëndëve civile që kanë të bëjnë me kontratat kolektive trendi i ardhjes së këtyre lëndëve ka qenë në rritje enorme edhe gjatë vitit 2023, kryesisht në tremujorin IV.



Lëndë të zgjidhura gjatë vitit 2013 kanë qenë 14.149 lëndë, gjatë vitit 2014 – 31.130 lëndë, gjatë vitit 2015 – 39.743, gjatë vitit 2016 – 41.095, për vitin 2017 janë zgjidhur gjithsejtë 39.758 lëndë,

gjatë vitit 2018 janë zgjidhur 27.016 lëndë, në vitin 2019 janë zgjidhur 15.192 lëndë, gjatë vitit 2020 janë zgjidhur 10.773 lëndë, gjatë vitit 2021 janë zgjidhur 10189 lëndë, gjatë vitit 2022 janë zgjidhur 12863 lëndë, ndërsa në vitin 2023 janë zgjidhur 13429 lëndë.



Angazhimi i gjyqtareve nga një divizion në tjetrin, me qëllim të zvogëlimit të numrit të lëndëve dhe zgjidhjes sa më të shpejt të tyre, ka reflektuar pozitivisht, në zgjidhjen e më shumë lëndëve dhe rritjen e efikasitetit të gjykatës.

Bazuar në planin vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Ferizaj për vitin 2023, si dhe planit të veprimit për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit, Gjykata Themelore e Ferizajt, me prioritet ka shqyrtuar edhe zgjidhjen e lëndëve me natyrë korruptive, në mënyrë që të njëjtat të përfundohen brenda periudhave sa më të shkurta kohore.

Sipas të dhënave statistikore lëndë të trashëguara të kësaj natyre nga viti 2023, kanë qenë nëntëmbëdhjetë (19) lëndë, janë pranuar në vitin 2023 njëmbëdhjetë (11) lëndë, ndërsa të kryera në këtë periudhë janë gjithsej dymbëdhjetë (12) dhe ka mbetur të pakryera tetëmbëdhjetë (18) lëndë të cilat janë në procedim e sipër nga gjyqtarët dhe pritet të përfundohen.

Efikasiteti i Gjykatës Themelore Ferizaj

Gjendja aktuale tregon se kemi bilanc pozitiv në disa divizione në raport me lëndët e kryera dhe të pranuar, dhe në tabelën në vijim paraqiten të dhënat për secilin departament/divizion

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera	Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuar x 100)
Procedura Paraprake - DP	155	161	316	135	181	83.85
Penale shkalla e parë- DP	1860	1101	2961	1267	1694	115.08
Procedurë Paraprake - DKR	115	142	257	193	64	135.92
Penale shkalla e parë - DKR	228	84	312	173	139	205.95
Penale për të mitur në proc.përgaditore	15	28	43	36	7	128.57
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	96	97	193	142	51	146.39
Civile të shkallës së I-rë	5928	4907	10835	3285	7550	66.95
Jashtëkontestimore	257	246	503	273	230	110.98
Përmbarimore	2599	1756	4355	1674	2681	95.33
Përmbarime sipas dokumenteve autentike	1349	24	1373	164	1209	683.33
Përmbarime sipas dokumentit përmbarues	738	676	1414	1019	395	150.74
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	3309	1062	4371	1042	3329	98.12
Ekz.civile PPP	228	172	400	153	247	88.95
Ekz.Penale me burg	169	131	300	180	120	137.40
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	958	545	1503	721	782	132.29
Ekz.i masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0	#DIV/0!
UGJK	0	0	0	0	0	#DIV/0!
GJITHËSEJT	18004	11132	29136	10457	18679	93.94
Lëndët tjera: çertifikata, vapistile, etj	0		0		0	#DIV/0!
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera	Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuar x 100)
Lëmia- Kundërvajtëse	3642	2403	6045	2972	3073	123.68
GJITHËSEJT	3642	2403	6045	2972	3073	

Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega së Gjykatës në Kaçanik

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera	Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuar x 100)
Procedura Paraprake - DP	101	93	194	72	122	77.42
Penale shkalla e parë- DP	850	314	1164	367	797	116.88
Procedurë Paraprake - DKR	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale shkalla e parë - DKR	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale për të mitur në proc.përgaditore	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Civile të shkallës së I-rë	1363	728	2091	518	1573	71.15
Jashtëkontestimore	358	39	397	131	266	335.90
Përmbarrimore	822	484	1306	122	1184	25.21
Përmbarrime sipas dokumenteve autentike	626	0	626	2	624	#DIV/0!
Përmbarrime sipas dokumentit përmbarrues	49	0	49	4	45	#DIV/0!
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	817	424	1241	429	812	101.18
Ekz.civile PPP	138	45	183	46	137	102.22
Ekz.Penale me burg	35	20	55	29	26	145.00
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	206	164	370	202	168	123.17
Ekz.i masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0	#DIV/0!
UGJK	0	0	0	0	0	#DIV/0!
GJITHËSEJT	5365	2311	7676	1922	5754	83.17
Lëndët tjera: certifikata, vaposhtë, etj	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera	Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuar x 100)
Lëmia- Kundërvajtëse	960	680	1640	703	937	103.38
GJITHËSEJT	960	680	1640	703	937	

Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega e Gjykatës në Shtërpçë

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuarra-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera	Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuarra x 100)
Procedura Paraprake - DP	4	10	14	10	4	100.00
Penale shkalla e parë- DP	182	87	269	159	110	182.76
Procedurë Paraprake - DKR	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale shkalla e parë - DKR	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale për të mitur në proc.përgaditore	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Civile të shkallës së I-rë	369	214	583	139	444	64.95
Jashtëkontestimore	22	17	39	14	25	82.35
Përmbartimore	154	146	300	79	221	54.11
Përmbartime sipas dokumenteve autentike	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Përmbartime sipas dokumentit përmbartues	17	0	17	0	17	#DIV/0!
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	133	93	226	120	106	129.03
Ekz.civile PPP	21	1	22	3	19	300.00
Ekz.Penale me burg	5	1	6	3	3	300.00
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	12	14	26	14	12	100.00
Ekz.i masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0	#DIV/0!
UGJK	0	0	0	0	0	#DIV/0!
GJITHËSEJT	919	583	1502	541	961	92.80
Lëndët tjera: certifikata, vapos tile, etj	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuarra-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera	Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuarra x 100)
Lëmia- Kundërvajtëse	146	141	287	232	55	164.54
GJITHËSEJT	146	141	287	232	55	

Zyra e Kryetarit

Kryetari i gjykatës për periudhën janar-dhjetor 2023 ka zhvilluar takime të kolegjiutit me gjyqtarë të gjykatës, janë mbajtur takime të rregullta me udhëheqës të departamenteve të gjykatës dhe me degët e gjykatës në Shtërpcë dhe në Kaçanik, ku është diskutuar lidhur me menaxhimin sa më efikas të gjykatës, organizimin e punës në Gjykatë, funksionet gjyqësore dhe udhëheqjen e departamenteve.

Çdo tre mujor dhe sipas nevojës, kryetar i gjykatës ka mbajtur takime të veçanta me gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda, Divizionit Penal, Divizionit Civil dhe Divizionit për Kundërvajtje.

Në fillim të vitit 2024, është mbajtur mbledhja e kolegjiutit të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe degëve në Kaçanik dhe Shtërpcë, ku është diskutuar lidhur me rezultatet e punës së gjykatës për vitin 2023, në veçanti janë diskutuar edhe raportet statistikore për secilin gjyqtar, janë dhënë edhe propozime për zgjidhjen efikase të lëndëve për secilin departament. Në kuadër të këtij takimi është diskutuar edhe për Draft planin e programit vjetor të punës së Gjykatës për vitin 2024, i cili është aprovuar dhe i njëjti i është dërguar Këshillit Gjyqësor për aprovim. Në kuadër të planit të punës është edhe Programi për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve, program i cili ngërthen në vete prioritetet dhe rekomandimet për secilin departament dhe divizion në përgjithësi.

Administrata

Personeli i gjykatës është menaxhuar mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, paanshmërisë, integritetit, transparencës, qëndrueshmërisë, shërbimit për publikun, meritës dhe vazhdimësisë në karrierë, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi, të cilat garantojnë shërbime efektive. Planifikim të duhur për rekrutim të stafit, i cili është dhe do të rekrutohet mbi bazën e meritave profesionale, në një proces të drejt dhe plotësisht transparentë.

Transparenca, informimi i publikut

Publiku ka qenë i informuar rregullisht mbi punën dhe veprimtarinë e gjykatës, përmes portalit gjyqësor e po ashtu edhe rrjeteve social, si me orarin e seancave, njoftimet e ndryshme ashtu edhe me vendimet gjyqësore, të cilat i kanë mundësuar publikut qasje më e lehtë në punën e gjykatës.

Të gjitha aktgjykimet janë publikuar në portalin e gjykatës, siç përcaktohet edhe me Udhëzimin Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve, dhe deri më sot në ueb janë të publikuara gjithsejtë afër trembëdhjetë dhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë (13.497) aktgjykime të anonimizuara, ndërsa vetëm në vitin 2023 janë publikuar 3009 aktgjykime të anonimizuara.

Web portali i gjyqësorit edhe për këtë periudhë ka shërbyer si urë lidhëse ndërmjetë publikut dhe gjykatës kjo me qëllim të informimit të publikut rreth aktiviteteve, orarit të seancave gjyqësore, vendimeve dhe të tjera, ndërsa përmes rrjetit social facebook publikut i është mundësuar qasje e lehtë në punën e gjykatës. Përveç këtyre shërbimeve të cilat ofrohen në portalin gjyqësorë dhe rrjetet sociale, si shërbime shtesë të cilat dëshmojnë transparencën e gjyqësorit karshi publikut, në hyrje të gjykatës janë të vendosur monitor të cilët pasqyrojnë kalendarin me orarin e seancave gjyqësore si dhe tabela orientuese, këto si në gjykatën Themelore në Ferizaj ashtu edhe në degët Kaçanik dhe Shtërpçë.

Gjatë vitit 2023, në sallat e Gjykatës Themelore në Ferizaj është implementuar projekti i instalimit të paisjeve audio vizive në sallat e gjykimeve, projekt i INL dhe Ambasada Amerikane në Kosovë. Për përdorimin e këtyre paisjeve ne si gjykatë kemi caktuar datat e trajnimit, për përdorimit të paisjeve për stafin, i cili trajnim do të bëhet nga zyrtarët e këtij projekti.

Gjykata Themelore në Ferizaj ka vazhduar me implementimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL), i cili ka treguar sukses dhe rritjen e efikasitetit dhe transparencës së gjykatës. Gjatë vitit 2023 raportet individuale të gjyqtarëve dhe raportet e përgjithshme të gjykatës, janë nxjerr vetëm përmes sistemit SMIL (edhe pse në secilin takim me gjyqtarët e kësaj gjykate janë ngritur shqetësime lidhur me pasqyrat e raporteve nga sistemi i SMIL në raport me lëndët fizike që i kanë në zyrë). Të gjitha kërkesat dhe aktakuzat e prokurorisë

së shtetit pranohen përmes SMIL, përjashtuar kërkesat konfidenciale (UGJK), po ashtu orari i seancave gjyqësore për publikim në ueb faqen e gjyqësorit është i lidhur direkt me SMIL, ndërsa me qëllim të digjitalizimit të punës së gjykatës dhe bazuar edhe në vendimin e KGJK-së, shumica e regjistrave manual janë larguar nga përdorimi.

Për të pasur pasqyrë më të saktë për numrin e lëndëve në Gjykatën Themelore në Ferizaj së bashku me degët ne si Gjykatë, kemi angazhuar zyrtarët e TI-së, së bashku me trajnerët e sistemit Smil, e të cilët kanë pasur mbështetjen edhe nga pjesa tjetër e administratës, të cilët kanë bërë barazimin e numrit të lëndëve në SMIL me ato fizike që kanë në punë gjyqtarët, pasi që ka pasur një pasqyrë jo të saktë të lëndëve të evidentuara në sistemin SMIL.

P Ë R F U N D I M I

Si përfundim vlerësojmë se viti 2023, ka qenë periudhë e suksesshme në aspektin e ngritjes së efikasitetit të përfundimit të lëndëve, të dhënat tregojnë një ngritje të shkallës së normës së spastrimit të çështjeve gjyqësore, mirëpo ardhja e një numri të madhe të lëndëve civile që kanë të bëjnë me kontratat kolektive (arsim, shëndetësi dhe polici), e kanë zbehur uljen e përqindjes në shkallë të përgjithshme të punës së kësaj gjykate.

Mustaf TAHIRI
Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj

